

# Programi suedez i vaksinimeve

## VAKSINIM VAJZASH KUNDËR HPV

*Prej 1 janar 2010 në programin e përgjithshëm të vaksinimit për fëmijë do të zbatohet edhe një vaksinim i ri. Vaksina do të mbrojë kundër një virusi që mund të shkaktojë kancer në qafën e mitrës dhe do t'i ofrohet të gjitha vajzave të lindura më 1999 e më vonë. Vajzat do të vaksinohen te infermierja e shkollës gjatë vijimit të klasës së 5-të dhe 6-të.*

### Për prindërit

Vaksina e re do të mbrojë deri në 70 për qind të rasteve të kancerit në qafën e mitrës. Kjo d.m.th. se me vaksinim rreziku ndaj sëmurjes nuk do të eliminohet tërësisht. Prandaj dhe është me rëndësi që vaksinimi të kompletohet me vizita të rregullta gjinekologjike dhe kontrollim të analizave qelizore që ofrohen më vonë. Vajzat që vaksinohen në moshë të re dhe që më vonë, në moshë të pjekur, bëjnë kontrollim të analizave qelizore do të kenë një mbrojtje shumë të mirë ndaj kancerit në qafë të mitrës.

Ju si prind mbase dëshironi të dini më shumë mbi këtë para se të vendosni nëse fëmiju juaj do të vaksinohet apo jo. Si mund një vaksinë të mbrojë nga kanceri? Si bëhet vaksinimi? Këtu mund të gjeni përgjegje në pyetjet më të zakonshme.

### Si mundet që një vaksinë të mbrojë nga kanceri?

Virusi që shkakton kancerin në qafë të mitrës quhet humana papillom virus (HPV). Virusi infekton nëpërmjet kontakteve seksuale. Shumica e vajzave do t'i nënshtrohen ndonjëherë në jetë këtij akti. Infektimi shpesh herë nuk vërehet fare dhe zakonisht shërohet vetvetiu.

Ndërkaq një numër i vogël i atyre që pësojnë mund të sëmuren nga infeksioni që mund të zgjasë me vite të tëra. Në rast të tillë ka rrezik që qelizat në qafë të mitrës të ndryshohen. Nëse qelizat e ndryshuara nuk vërehen dhe mënjahohen me kohë ato mund të zhvillohen në kancer.

Ekzistojnë qindra lloje të këtij virusi dhe së paku 14 prej tyre mund të shkaktojnë kancer. Vaksina drejtohet kundër dy tipave të virusit që më së shpeshti shkaktojnë sëmundjen. Në praktikë vaksinimi ofron mbrojtje në 70 për qind të rasteve të kancerit në qafë të mitrës.

Vaksina mbron vetëm atëherë kur nuk jeni infektuar. Prandaj dhe është me rëndësi që vaksinimi të bëhet para debutimit seksual, ose sa më parë që të jetë e mundur pas debutimit seksual.

### Vaksina dhe analiza e qelizave janë masa komplementare në mbrojtjen kundër kancerit në qafë të mitrës

Falë programit suedez për analiza qelizore sot ekziston një mënyrë efektive në mbrojtjen kundër kancerit në qafë të mitrës. Me anë të këtij programi të gjitha femrave prej moshës 23 deri në 60 vjeçare u ofrohen vizita të rregullta për të bërë analiza qelizore. Kontrollimi është i thjeshtë dhe nuk shkakton dhembje. Analiza ka për qëllim të zbulojë ndryshime eventuale qelizash në disa pjesë të mitrës dhe në qafë të mitrës, para se ato të arrijnë të zhvillohen në kancer. Ky program është duke u aplikuar që nga vitet e 1960-ta dhe ka bërë që numri i të vdekurve nga kanceri në qafë të mitrës të bie dukshëm.

Pasi që 30 për qind të rasteve të kancerit në qafë të mitrës nuk mbrohen nga vaksina, është me rëndësi që vajzat në moshtë të pjekur t'i nënshtrohen kontrollit të analizave qelizore.

Vajzat që vaksinohen dhe i nënshtrohen kontrollit të analizave qelizore më vonë do të kenë mbrojtje të mirë ndaj sëmundjes. Ky kombinim llogaritet që në të ardhmen për çdo vit do të kursejë jetëra të shumë femrave në Suedi.

### Si bëhet vaksinimi?

Vaksinimin e bën infermierja e shkollës. Vaksina injektohet në muskulin e jashtëm të pjesës së sipërme të krahut. Për të arritur efekt të plotë vajzat duhet të vaksinohen tri herë brenda periudhës kohore prej pesë deri në shtatë muaj.

### Cilat janë efektet e mundshme anësore të vaksinimit?

Shumica e vajzave nuk përjetojnë fare efekte anësore. Disa prej efekteve anësore janë megjithatë më të zakonshme se tjerat, për shembull vendi i shpimit mund të skuqet, të bëhet i ndjeshëm dhe ndoshta ënjtet. Disa mund të kenë simptoma në stomak (mund, vjellje dhe diarre), kokëdhembje, muskuj të ndjeshëm ose të ndjehen në përgjithësi të molisur.

Efekte të pazakonshme anësore mund të jenë marramendje, infektim të fytit, ngurosjë në vendin e shpimit ose mpirje në pjesën rreth vendit të shpimit.

### Fakte mbi kancerin në qafë të mitrës

Mosha mesatare e femrave që sëmuren nga kanceri në qafë të mitrës në Suedi është mosha 54 vjeçare. Shumica e tyre infektohen nga HPV para se t'i kenë mbushur 20 vite. Infektimi viral ka zgjatur me vite të tëra dhe me kalimin e kohës ka shkakuar ndryshimin e qelizave. Ndryshimi i qelizave më vonë është zhvilluar në kancer.

Kanceri në qafë të mitrës është një sëmundje serioze. Rreth 250 000 femra në botë vdesin për çdo vit nga kjo sëmundje.

Në Suedi për çdo vit sëmuren 450 femra e rreth 150 prej tyre vdesin nga kjo sëmundje. Statistikat mbi rastet serioze të kancerit në qafë të mitrës tregojnë sa e rëndësishme është që rregullisht t'i nënshtroheni analizave qelizore. Tetë nga dhjetë prej atyre që sëmuren rëndë nga kanceri në qafë të mitrës nuk i janë nënshtruar rregullisht kontrollave ose fare nuk kanë bërë kontrollin.

### Pyetje të zakonshme

*A do ti mbrojtë tërësisht vajzat nga kjo sëmundje vaksina kundër kancerit në qafë të mitrës?*

Jo, vaksina mbron përafërsisht 70 për qind të rasteve të kancerit në qafë të mitrës.

*A i ka bërë vaksinimi kundër kancerit në qafë të mitrës të panevojshme kontrollin e analizave qelizore?*

Assesi, pasi që 30 për qind të vajzave të vaksinuara mbeten të pambrojtura nga kanceri në qafë të mitrës. Prandaj është shumë me rëndësi që edhe vajzat e vaksinuara t'i nënshtrohen kontrollimit gjinekologjik të analizave qelizore, që atyre do t'u ofrohet prej moshës 23 vjeçare.

*A është vaksinimi fare i nevojshëm kur dihet se ekziston një mënyrë për të zbuluar ndryshimin e qelizave para se ato të zhvillohen në kancer të qafës së mitrës?*

Hulumtimet tregojnë se kombinimi i vaksinës dhe kontrollimi i analizave qelizore përforcojnë mbrojtjen ndaj sëmundjes, dhe kjo do t'u kursejë jetën shumë femrave.

*A është e nevojshme që vaksinimi të përtërihet më vonë në jetë?*

Për momentin nuk dihet nëse vaksinimi duhet të përtërihet dhe, në rast se duhet, kur duhet të bëhet kjo. Për këtë arsye Udhëheqësia për çështje sociale (Socialstyrelsen) do të përcjellë me vëmendje vijimin në hulumtimet rreth efektit të vaksinës që me siguri më të madhe të marrë vesh sa zgjat efekti i saj.

*Pse HPV-vaksinimi i ofrohet vetëm vajzave?*

Meqenëse nga kanceri në qafë të mitrës pësojnë vetëm vajzat, deri më tani në radhë të parë janë studiuar efektet e vaksinimit të vajzave. Mirëpo edhe janë duke u bërë studime se në ç'masë vaksina do të mund të mbronte djemtë nga lloje tjera të kancerit.

### Doni të dini më shumë?

Fillimisht mund t'i drejtoheni personelit shëndetësor të shkollës.

#### ME RËNDËSI

**Para vaksinimit** – Na lajmëroni nëse fëmiju juaj është alergjik apo nëse ka reaguuar në mënyrë jonormale ndaj vaksinimeve të mëparshme.

**Pas vaksinimit** – Kontaktoni personelin shëndetësor të shkollës nëse te fëmiju juaj vëreni diç të pazakonshme në ditët e para pas vaksinimit.